

Universiteti 'Eqrem Çabej' vijon angazhimin në kuadër të projektit SINCERE

Në kuadër të zbatimit të projektit **SINCERE**, vijojnë takimet e koordinimit dhe aktivitetet e përbashkëta të partnerëve, me fokus në përbushjen e objektivave dhe rezultateve të parashikuara në projekt. Në takimin e koordinimit të zhvilluar online më **8 shtator 2026**, partnerët diskutuan mbi ecurinë e aktivitetëve të periudhës së ardhshme, si dhe mbi hapat e mëtejshëm për përbushjen e detyrimeve të projektit.

Një nga çështjet kryesore të diskutimit ishte **Quality Plan (D1.4)**, për të cilin vijon puna për rishikimin dhe finalizimin e dokumentit, me synim ridërgimin e tij në portalin Sygma në 15 Tetor 2026.

Në vijim të aktivitetëve të projektit, është planifikuar organizimi i dy workshop-eve me stafin akademik dhe strukturat e tjera të UGJ-së, bazuar në Kornizën e Integritetit Akademik tashmë të miratuar në projekt.

UGJ do të vijojë me procedurat administrative dhe financiare për sigurimin e pajisjes hardware, në përputhje me kërkesat dhe procedurat e projektit, ndërsa UBT i Prishtinës është në procedurat e tenderimit të pajisjeve software për të gjithë partnerët e konsorciumit.

Në përfundim takimi u fokusua në organizimin e dy Workshop-eve me UGJ, finalizimin e Quality Plan D1.4, procedurat administrative dhe financiare për pajisjet hardware dhe software, si dhe përgatitjen e kuadrit për integritetin akademik.

